



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/16/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën disiplinore të parashtruar në mënyrë anonime, andaj duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 4 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, par. 2 nën-par. 2.1 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 12.04.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Hudhet si e palejuar ankesa disiplinore e parashtruar në mënyrë anonime në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 29.03.2022 përmes emailit ka pranuar ankesën disiplinore (të paevidentuar identitetin e subjektit fizik i cili ka paraqitur ankesën).

Pasi ankesa e parashtruar përmes email-it nuk ka përmbajtur elementet e parapara me nenin 5 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoriteti Kompetent duke u bazuar në nenin 6 par.2 të Rregullores Nr.05/2019, me datë 29.03.2022 përmes emailit ka kërkuar nga parashtruesi që brenda 8 ditëve të bëjë plotësimin e të dhënave duke përfshirë edhe identitetin e tij/saj.

Pasi parashtruesi brenda afatit 8 ditor nuk ka bërë plotësimin e të dhënave të kërkuara, duke përfshirë identitetin e tij/saj, Autoriteti Kompetent ka vlerësuar se e njëjta duhet të hudhet si e palejuar.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 9, paragrafi 4 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, par. 2 nën-par. 2.1 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/15/22, me datë 12.04.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë